



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 117

Tiranë – E hënë, 22 qershor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11515, datë 18.6.2020	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 6939
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 478, datë 17.6.2020	Për kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reparti ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar..... 6939
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 479, datë 17.6.2020	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen e fëmijëve në punë”..... 6943
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 480, datë 17.6.2020	Për një ndryshim në vendimin nr. 387, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e garancisë shtetërore të huas me bankat tregtare, për garantimin e huamarrjes së tregtarëve ose shoqërive tregtare, për të mundësuar financimin e nevojshëm për rimëkëmbjen e aktivitetit tregtar të ndikuar nga situata e krijuar nga COVID-19, si edhe për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve të marrëveshjes së garancisë dhe marrëveshjes së mirëkuptimit”..... 6950
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 484, datë 17.6.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Krijimi i qendrave të fshatrave, me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishteje, në fshatin Mbrakull”, Poliçan..... 6951
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 17.6.2020	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i dy fiderave të rinj kabllorë, fideri F9 dhe fideri F10, me izolacion 20 kV, nënstationi i ri 110/20 kV, Plastmasa, Lushnjë”..... 6954

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 486, datë 17.6.2020	Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të Arsimit Parauniversitar.....	6955
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 488, datë 17.6.2020	Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950 295 959 lekësh, në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”	6957
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 489, datë 17.6.2020	Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njërive të banimit në ndërtesa (pallat) në bashkitë Kamzë dhe Kavajë.....	6960
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 16, datë 12.6.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 28, datë 12.12.2019, “Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve kombëtare të Maturës Shtetërore 2020”, të ndryshuar.....	6960
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 24, datë 16.6.2020	Për regjistrimin e pagesave të faturave elektronike.....	6961

**DEKRET****Nr. 11515, datë 18.6.2020****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tij, personit të mëposhtëm:

Lumnije Murat Aliu (Zeka)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta**

VENDIM**Nr. 478, datë 17.6.2020**

**PËR KALIMIN NË PRONËSI, NGA
MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
TIRANË, TË NJË SIPËRFAQEJE
TRUALLI FUNKSIONAL DHE TË DISA
OBJEKTEVE, BRENDA TERRITORIT TË
PRONËS NR. 99, ME EMËRTIM “ISH-
REPARTI USHTARAK NR. 5011/45”, ME
VENDNDODHJE NË SURREL, FARKË,
TIRANË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË
VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT
TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË
PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar,

dhe të neneve 3, 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë, të një sipërfaqeje trualli funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reparti ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Hiqen trualli funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 3 300 (tre mijë e treqind) m², nga trualli funksional i pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reparti ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë.

b) Përmasat e pronës nr. 99, me emërtim “Ish-Reparti ushtarak nr. 5011/45”, me vendndodhje në Surrel, Farkë, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Bashkia Tiranë të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin, duke i kthyer në gjendjen e tyre të mëparshme, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës, e cila i kalon në pronësi, sipas parametrave e kushteve teknike dhe për këtë të hartohet aktmarrëveshje ndërmjet Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.



4. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Bashkia Tiranë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN VENDOSJA Prona nr.99 "Ish rep. usht. Nr.5011/45" Surret, Tiranë Sipërfaqja dhe objektet që i mbeten pronës	
MIRATOHET KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE Gjeneral Brigade NDIQIM SALLAKU Hartoi Topograf Ramiz Haxhiu Tetor 2019	IDENTIFIKIMI I PASURISE Zona Kadastrale 2380 Nr.Pasurise Vol. Fq Indeksi i Hartes K-34-88-(254-C) Shkalla 1: 2500 Adresa e pasurise, Tiranë Q/F Surret, Tiranë Pronari : Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse

Shpjeguese

Sip. e përgjithshme që i mbetet pronës = **57 150.0m²**
 = **2 163.3 m²**

Sip. nën objekte

Sip. nën objektin nr.1 = 28.6m²

Sip. nën objektin nr.2 = 198.4m²

Sip. nën objektin nr.5 = 424.9m²

Sip. nën objektin nr.6 = 199.2m²

Sip. nën objektin nr.7 = 389.0m²

Sip. nën objektin nr.8 = 392.9m²

Sip. nën objektin nr.9 = 256.0m²

Sip. nën objektin nr.10 = 178.0m²

Sip. nën objektin nr.11 = 96.3m²

— Kufiri i repartit

Shënim :

Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.6539/1, datë 25.10.2019, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJiU, azhronimit të kryer në terren në prani të përfaqësuesit të KM, hedhur mbi ortofoton dhe kuadrin e bashkimit të HTR të dhënë nga Drejtoria Vendore e ASHK, Tiranë.




PLAN VENDOSJA

Prona nr.99 "Ish rep. usht. Nr.5011/45" Surrel, Tiranë
Sipërfaqja dhe objektet që kërkohen për kalim në pronësi nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Tiranë

MIRATOHET

KOMANDANTI I KOMANDËS MBËSHTETËSE

Gjeneral Brigade NDRICIM SALLAKU

ZV/DREJTORI I IGJIU
Ark. ENEA SINOIMERI

IDENTIFIKIMI I PASURISE

Zona Kadastrale 2380

Nr. Pasurise Vol. Fq

Indeksi i Hartes K-34-88-(254-C)

Shkalla 1: 2500

Adresa e pasurise, Tiranë

Q/F Surrel, Tiranë

Pronari :

Ministria e Mbrojtjes, Komanda Mbështetëse

Hartoi


Topograf Ramiz Haxhiu

Tetor 2019



Shpjeguese

Sip. e përgjithshme për kalim Bashkisë Tiranë = 3 300 m²Sip. nën objekte = 466.2 m²Sip. nën objektin nr.4 = 133.7m²Sip. nën objektin nr.3 = 303.9m²Sip. nën objektin nr.12= 28.6m²
 Sip. dhe objektet për kalim Bashkisë Tiranë

 Kufiri i repartit


Shënim :

Ky planrilevimi u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.6539/1, datë 25.10.2019, bazuar në dokumentacionin hartografik të kësaj prone marrë në arkivin e IGJIU, azhormit të kryer në terren në prani të përfaqësuesit të KM, Bashkisë Tiranë dhe përfaqësuesi i SHIPT Z.Ndreke Ismailaj, hedhur mbi ortofoton dhe kuadrin e bashkimit të HTR të dhënë nga Drejtoria Vendore e ASHK, Tiranë.



3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHETËRORE

(Për inventarizimin e pronave si klasa të veçanta)

Ministria e Mbrojtjes			Identifikoi: Major Arben SOPAJ, Specialist per Pronat në KM							
Komanda Mbështetëse			Major Tefik KAMBO, Specialist Infrastruktura Rep Usht 4006							
Bashkia Tiranë			Supervizoi: N/Kolonel Ferdi HYRAJ, Shef i Sektorit të Pronave në KM							
			N/Kolonel Rudina KADRIU, Shef Finance në KM							
Fusha e përdorimit të pronës: Për mbrojtjen			Aprovoi Gjeneral Brigade Ndrçim SALLAKU, Komandant							

Nr	A		B			C				
	Zona Kadastrale, Indeksi i Hartes	Numri i pasurisë	Emërtesa e pronës	Komponentet përbërës të pronës	Adresa, vendndodhja e komponentëve përbërës	Përmasat e pronës në m ² ose ml	Funksioni për të cilin përdoret prona	Enti me përgjegjësi administrative	Enti përdorues, Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera, shënime të vecanta
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
99	2380 K-34-88- (254-C)		Ish Repart Ushtarak nr.5011/45		Surrel Tiranë	57150 m ²	Per Mbrojtjen	MM, Rep.Usht. Nr.4001	Rep.Usht. Nr.4006	Objekti nr.3, nr.4 dhe nr.12 (466.2 m ² sipërfaqe ndërtimi) bashkë me sipërfaqen prej 3300 m ² i kalojnë Bashkisë Tiranë (Shoqatën e Invalidëve Para & Tetraplegjikë të Shqipërisë)
				Objekti nr.1 (Ish Depo)		28.6 m ²				
				Objekti nr.2 (Ish Depo)		198.4 m ²				
				Objekti nr.5 (Ish Qendër Stërvitore))		409.9 m ²				
										2 kt

				Objekti nr.6 (Ish Depo)		199.2 m ²				
				Objekti nr.7 (Depo)		103.7 m ²				
				Objekti nr.8 (Ish Depo)		392.9 m ²				
				Objekti nr.9 (Depo)		407.1 m ²				
				Objekti nr.10 (Ish Depo)		156 m ²				
				Objekti nr.11 (Ish Truprojë)		267.5 m ²				
				Linjë elektrike		(1000 ml)				Nuk ekziston
				Linjë ujësjellësi		(2000 ml)				Nuk ekziston
				Tunel nr.1		(360 m ²)				
				Tunel nr.2		(360 m ²)				
				Truall		54986.7 m ²				



VENDIM
Nr. 479, datë 17.6.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 108, DATË 15.2.2017,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
MBROJTJEN E FËMIJËVE NË PUNË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 98, pika 4, 99, pika 3, 102 dhe 103, pika 3, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, emërtimet “Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministria e Shëndetësisë” zëvendësohen, përkatësisht, me fjalët “... ministria përgjegjëse për punën ...” dhe “... Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ...”.

2. Pas pikës 4, të nenit 6, të tekstit të rregullores, bashkëlidhur vendimit, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

“5. Për identifikimin dhe kontrollin e formave të punës së ndaluar të fëmijëve, inspektorët e punës zbatojnë udhëzuesin praktik, sipas shtojcës nr. II, bashkëlidhur këtij vendimi.”.

3. Në titullin e shtojcës I, bashkëlidhur vendimit, referenca “... në nenin 7, pika 2 ...” zëvendësohet me “... në nenin 6, pika 2 ...”.

4. Pas shtojcës I, bashkëlidhur vendimit, shtohet shtojca II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA II
UDHËZUES PRAKTIK PËR
INSPEKTORËT E PUNËS PËR
IDENTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN E
FORMAVE TË PUNËS SË NDALUAR TË
FËMIJËVE DHE REAGIMIT TË DUHUR
NDAJ SAJ

Në këtë shtojcë përcaktohen udhëzimet për inspektorët e punës për identifikimin e formave të punës së ndaluar të fëmijëve dhe reagimit të duhur ndaj saj.

Në kuadrin e këtij udhëzimi, termi “fëmijë” nënkupton çdo person nën moshën 18 vjeç.

Dallimi mes “punës së lejuar të fëmijës” dhe “punës së ndaluar të fëmijës” konsiderohet **“Punë e ndaluar e fëmijës është çdo punë e kryer nga fëmija, e cila është në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe i shkakton dëm apo rrezikon shëndetin, zhvillimin mendor, fizik, shoqëror dhe social të fëmijës”**. Këtu përfshihet çdo punë e detyruar, si dhe çdo punë e cila nuk lejon ose pengon fëmijën të ndjekë arsimin e detyruar.

Puna e ndaluar e fëmijës do të thotë që një fëmijë i mohohet mundësia për të shfrytëzuar potencialin e tij të plotë dhe mundësia për të dhënë kontributin e tij të plotë.

Në luftën kundër punës së ndaluar të fëmijëve, inspektorët e punës duhet të jenë të vetëdijshëm për këto probleme:

Dallimi mes formave “punë e lejuar” apo e “punë e ndaluar” e punës

Përgjegjësi e inspektorëve të punës është identifikimi i rasteve kur fëmijët punojnë dhe nëse kjo punë është një formë e “lejuar” apo e “ndaluar” e punës. Ky proces nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë:

- Aty ku ekziston puna e fëmijëve, mund të ndodhë në shtëpi apo ferma familjare, objekte të nënkontraktuara ose diku më poshtë zinxhirit të furnizimit, ku identifikimi i saj mund të jetë më i vështirë për inspektorët;

- Nëse data e lindjes nuk regjistrohet zyrtarisht, fëmijët dhe të rinjtë mund të mos e dinë moshën e tyre të saktë;

- Nëse punëdhënësit janë të vetëdijshëm se inspektorët kërkojnë fëmijë të përfshirë në punë të ndaluar, mund të përpiqen ta fshehin këtë çështje – duke u thënë fëmijëve të shkojnë në shtëpi ose të



dalim jashtë të luajnë kur e dinë se do të vijnë inspektorët; dhe

- Vetë fëmijët që punojnë mund të duan t'i mbrojnë punët e tyre – praktika si sigurimi i kartave të falsifikuara të identitetit nuk janë të pazakonta.

Një problem në praktikë është gjetja dhe aksesimi në vendet e punës, ku ndodh më shpesh puna e fëmijëve – ana informale e ekonomisë. Për të gjurmuar rastet e punës së fëmijëve, inspektorët duhet të dalin në komunitet dhe ta shtrijnë aktivitetin e tyre në terren.

Vlerësimi i risqeve të vendit të punës për fëmijët

Puna e papranueshme e fëmijëve është puna që dëmton mirëqenien dhe arsimin e fëmijës dhe që pengon zhvillimin dhe standardet e tij të ardhshme të jetesës. Një nga përgjegjësitë e Inspektoratit të Punës, në lidhje me kontrollin e punësimit të fëmijëve, është parandalimi i dëmeve që mund t'u ndodhin në vendin e punës.

Risqet e punësimit të fëmijëve nuk vijnë vetëm nga natyra e punës që ata kryejnë, por mund të jenë, gjithashtu, rrjedhojë e termave dhe kushteve në të cilët ata punojnë dhe nga natyra e mjedisit ku punojnë. Dëmet mund të bien mbi fëmijët në çfarëdo lloji mjedisi pune: Kështu:

- **“Dëmi fizik”** në vendin e punës – dëmet fizike mund t'u shkaktohen fëmijëve nga punëdhënës ose punonjës të tjerë abuzivë, ndërkohë që ka edhe dëme që mund të lindin për shkak të detyrimit të tyre për të ndërmarrë punë të rrezikshme ose të vështira që çojnë në aksidente në vendin e punës.

- **“Dëmi seksual”**, rreziku i dëmeve seksuale mund të lindë në shumë vende pune: fëmijët që punojnë mes të rriturve mund të jenë të cenueshëm ndaj dëmeve seksuale, duke përfshirë sulmet seksuale nga punëdhënës apo punonjës të tjerë abuzivë.

- **“Dëmi emocional”**, dëmet emocionale mund të lindin për shkak të angazhimit në punë të papranueshme të fëmijës, madje edhe në kontekstin familjar. Këto dëme mund të lindin, gjithashtu, madje në mënyrë më traumatike, edhe nga trafikimi i fëmijës nga prindërit ose kujdestarët, me qëllim shfrytëzimin e punës nga një palë e tretë.

- **“Shfrytëzimi”**, abuzimi fizik mendor apo emocional ose neglizhimi i një fëmije për përfitime financiare ose përfitime të tjera. Këtu përfshihet shfrytëzimi seksual komercial, trafikimi i fëmijëve, martesat e fëmijëve dhe puna e fëmijëve. Me fjalë

të tjera, në rastet kur manifestohet shfrytëzimi, ai është tregues i sigurt i punës së papranueshme të fëmijëve.

Puna duhet të konsiderohet si punë e ndaluar për fëmijës nëse fëmijët:

- punojnë nën tokë, nën ujë, në lartësi të rrezikshme ose hapësira të kufizuara;

- punojnë me makineri, pajisje dhe mjete të rrezikshme ose që përfshijnë manovrimin manual ose transportimin e peshave të rënda;

- puna që mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj substancave, agjentëve ose proceseve të rrezikshme ose temperaturave, niveleve të zhurmës ose dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;

- puna në kushte veçanërisht të vështira, si për shembull, për orare të gjata ose gjatë natës;

- çdo punë fëmijësh mund të kthehet në punë të ndaluar për fëmijët, nëse fëmijës i duhet të punojë për një numër jashtëzakonisht të madh orësh ose të shkëputet nga shkolla;

- identifikimi i punës së lejuar të fëmijës dhe punës së ndaluar të fëmijës varet nga njohja e hollësishme e rreziqeve që përbën për fëmijët puna që atyre u kërkohet të kryejnë, kushtet në të cilat ata punojnë, si dhe natyra e mjedisve specifike të punës ku ata punojnë. Prandaj, inspektorët e punës duhet të vlerësojnë jo vetëm rreziqet që dalin nga natyra e punës së kryer nga fëmijët, por edhe nga punëdhënësi ose punonjësit e tjerë, vendi i punës dhe vetë mjedisi i punës;

- për identifikimin e rasteve të punës së lejuar të fëmijëve, inspektorët duhet të komunikojnë fillimisht me punëdhënësit, të cilët mund të jenë në të vërtetë prindi i fëmijës, në lidhje me rreziqet që përbën për fëmijët puna në moshë të hershme, ta informojnë atë në lidhje me legjislacionin dhe me masat që kërkon ligji, si dhe ta bindin atë të veprojë në përputhje me to dhe se kjo do të ishte në interesin më të lartë të tij (dhe sigurisht dhe të fëmijës) në planin afatgjatë;

- për identifikimin e rasteve të punës së ndaluar të fëmijëve, inspektorët, gjithashtu, duhet të informojnë strukturat e duhura të mbrojtjes së fëmijëve dhe të koordinohen me to për masat e përshtatshme për mbrojtjen e fëmijës.

Përgjegjësitë e inspektorëve të punës ndaj fëmijëve që punojnë

- Një pjesë e madhe e punës së ndaluar të fëmijëve ndodh në kontekstin familjar. Megjithatë, edhe nëse lejohet nga njëri prind i



fëmijës, ajo është prapëseprapë punë e ndaluar e fëmijës, nëse dëmton **interesat më të lartë të fëmijës**.

- Përgjithësisht, nuk duhet të punësohet asnjë fëmijë nën moshën 16 vjeç, përveçse gjatë kohës së pushimeve, kur fëmijët mbi moshën 15 vjeç mund të punësohen në punë të “lehta”.

- Në rastet kur fëmijët përfshihen në aktivitete kulturore, artistike, sportive ose argëtuese, ata duhet të marrin paraprakisht një autorizim nga Inspektorati i Punës. Megjithatë, duke pasur parasysh se mungesa e punëve dinjitoze për të rriturit është në vetvete shkak i punës së fëmijëve, inspektorët duhet të jenë jashtëzakonisht të kursyer në dhënien e autorizimeve të tilla, kur për përmbushjen e këtyre roleve mund të punësohet shumë mirë një i rritur.

- Asnjë fëmijë nuk duhet të punësohet në punë që kryhen natën.

- **“Sklavëria e fëmijëve”**, transferimi i një fëmije te një palë e tretë nga prindi ose kujdestari, për qëllim shfrytëzimi, **ndalohet plotësisht**.

- Të gjitha format e tjera më të rënda të punës së fëmijëve, duke përfshirë prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve; përdorimin e fëmijëve për aktivitete të paligjshme, veçanërisht për prodhimin dhe trafikimin e drogave; si dhe puna që mund të dëmtojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve, janë të ndaluara.

- Mundet që çfarëdolloj burimi i vetëm informacioni, për shembull, dokumente identiteti të falsifikuara, mund t'i çorientojnë inspektorët sa i përket nivelit të pranueshmërisë së punës së fëmijëve. Prandaj, është e rëndësishme, që, sa herë që është e mundur, të përdoret **“trekëndëshi”** i informacionit. Inspektimet për vlerësimin e punës së papranueshme të fëmijëve duhet të shohin mundësinë e gjetjes së **provave shkresore**, në lidhje me moshën, termat dhe kushtet, **respektimin** e ligjit nga ana e vendit të punës, si dhe **intervistat** me punëtorët, duke përfshirë fëmijët dhe të rinjtë. Përveç kësaj, **aty ku është e mundur, duhet të kërkojnë prova edhe nga aktorë të tjerë**, si shkollat, punonjësit e shëndetit dhe policisë.

Ndalohet plotësisht rekrutimi, shitja, transportimi, fshehja, strehimi ose pranimi i një fëmije për qëllim shfrytëzimi.

Kuadri i monitorimit të punës së fëmijëve

Modeli i monitorimit të punës së fëmijëve (MPP), i përcaktuar në këtë udhëzim, ka katër elemente:

- **Identifikimi:** Kjo përfshin vizitat në vendin e punës ku mund të punojnë fëmijët, konstatimin e asaj çka ndodh sa i përket llojit të punës, standardit të shëndetit dhe sigurisë, orarit të punës, pagave dhe marrëdhënieve të punësimit.

- **Referimi:** Njoftimin e strukturave përgjegjëse për fëmijët që janë nën moshën ligjore në vendin e punës, duke përdorur procedurat, për të cilat është rënë dakord me shërbimet sociale dhe ofruesit e arsimit. Kjo duhet të bëhet në mënyrë të shpejtë, nëse puna e fëmijëve është e rrezikshme dhe në mënyrë më të matur nëse lloji i punës nuk konsiderohet se kërkon ndërhyrje të menjëhershme.

- **Mbrojtja dhe parandalimi:** Verifikimi i vendit të punës për të parë nëse ka menaxhim të rrezikshëm apo jo të mirë të shëndetit dhe sigurisë, ndaj të cilit mund të ekspozohen fëmijët. Më pas, masat e marra për të mos lejuar punësimin e fëmijëve të tjerë të rinj në këto vende pune.

- **Mbledhja dhe analizimi i të dhënave:** Informacioni dhe të dhënat e mbledhura nga vizitat monitoruese regjistrohen dhe u shpërndahen menaxherëve të inspektimit dhe aktorëve të tjerë të interesuar, si shërbimet sociale.

Struktura përgjegjëse për shërbimin social në bashki është institucioni përgjegjës kyç për ofrimin e gamës së plotë të shërbimeve [të mbrojtjes së fëmijëve], duke përfshirë identifikimin, ofrimin e ndihmës së menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht, duke përfshirë ata në situatë rrugë.

Në rast se inspektorët e punës konstatojnë raste të shfrytëzimit të fëmijëve, ata duhet ta raportojnë menjëherë rastin te punonjësi përkatës i mbrojtjes së fëmijëve, **në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal, të cilat bashkëpunojnë me strukturat e policisë”**.

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore pranë bashkisë është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ndërmjet strukturave në varësi të saj dhe në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë dhe institucionet e tjera vendore me mekanizmat vendorë të mbrojtjes merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijëve në territorin e bashkisë.

Punët e ndaluara për fëmijët (punëmarrësit nën 18 vjeç)

Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë parashikon “masa të posaçme mbrojtjeje për të miturit (fëmijët) nga çfarëdolloj pune që ka gjasa të jetë e rrezikshme



për shëndetin e tyre, që mund të dëmtojë moralin e tyre apo që mund të ndikojë në arsimimin e tyre”.

Punë të rrezikshme për punësimin e punëmarrësve nën 18 vjeç konsiderohen:

- puna nën tokë, puna nën ujë, në lartësi të rrezikshme ose në hapësira të kufizuara;
- puna me makineri, pajisje dhe mjete të rrezikshme ose puna që përfshin manovrimin manual ose transportin e peshave të rënda;
- puna që mund t'i ekspozojë fëmijët ndaj substancave të rrezikshme, agentëve apo proceseve ose temperaturave, niveleve të zhurmës ose të dridhjeve që dëmtojnë shëndetin e tyre;
- puna në kushte veçanërisht të vështira, si puna me orë të gjata ose puna gjatë natës;
- puna në ngritjen dhe mbajtjen e peshave të rënda;
- puna në lartësi;
- puna në mirëmbajtjen e një makinerie të pambrojtur që është në lëvizje;
- operimin e makinerive që nuk janë plotësisht të ruajtura;
- ekspozimin ndaj kimikateve shumë toksike, toksike dhe të dëmshme, duke përfshirë karcinogenët e listuar;
- ekspozimin ndaj asbestos;
- ekspozimin ndaj rrezatimeve të dëmshme jonizuese;
- punën me agentë biologjikë me “risk të lartë”;
- operimin e vinçave, ngritësve të peshave mekanike dhe automatike;
- punën që mund të rezultojë në kontakt me energjinë elektrike të tensionit të lartë, ku ekziston risku i shokut elektrik;
- puna në kushte jonormale nxehtësie, të ftohti, dridhjes dhe zhurme – puna me makineri prerjeje që punojnë me energji elektrike.

Punët e përgjithshme të ndaluara për fëmijët përfshijnë:

- punën në thertore;
- përzierjen dhe aplikimin e pesticideve dhe ekspozimin gjatë spërkatjes nga ajri – prodhimin, manovrimin dhe magazinimin e lëndëve eksplozive dhe artikujve që përmbajnë materiale eksplozive;
- punën që përfshin ekspozimin ndaj përbërësve të plumbit, si: gazë, plumburi ose avulli, duke përfshirë punën me bojëra me nivel të lartë plumbi;
- punën që përfshin prodhimin dhe manovrimin e metaleve të shkrira;
- zhytjen komerciale dhe punën nën ujë;

- peshkimin në thellësi të mëdha të detit;
- ngarkimin/shkarkimin e anijeve;
- punën në miniera dhe punën nën tokë;
- makineri të prerjes së drurit që punojnë me energji elektrike;

- rrëzimin e pemëve dhe prerjen më pas të tyre;
- punën me kafshë të egra të rrezikshme dhe helmuese;
- punën e prishjes së ndërtesave;
- çmontimin e anijeve;
- puna që kryhet për mbledhjen, grumbullimin, riciklimin e plastikës, skrapit, mbetjeve urbane.

Siç theksohet më sipër, mosha mesatare e punës është vendosur mosha 16 vjeç, ndërkohë që puna gjatë natës është e ndaluar për të gjithë të punësuarit nën moshën 18 vjeç. Të punësuarit nën moshën 18 vjeç nuk lejohet të punojnë për më shumë se 6 orë në ditë. Të miturit e moshën 15 deri 16 vjeç mund të punojnë vetëm gjatë pushimeve të shkollës, me kusht që të punësohen për punë të lehta dhe që Inspektorati i Punës të ketë lëshuar një autorizim paraprak pune për punëdhënësin. Të paktën një herë në vit, të miturit e moshës 1 –16 vjeç duhet të bëjnë një periudhë prej 4 javësh pushim nga çdo aktivitet shkollor dhe çdo lloj pune.

Në këtë kontekst, duhet të kuptohet qartë se çdo punë e lejuar për fëmijët mund të kthehet në punë të ndaluar, nëse ajo menaxhohet në mënyrë të tillë që dëmton të drejtat themelore të fëmijëve.

Inspektorët duhet të kenë gjithmonë parasysh se ajo çka është e rrezikshme për të rriturit është patjetër edhe më e rrezikshme për fëmijët.

Prandaj, inspektorët e punës duhet të kenë gjykimin e tyre profesional në të gjitha situatat e punësimit të fëmijëve për të vlerësuar nëse puna e kryer është e ndaluar, për shkak të orarit të gjatë, termave dhe kushteve të papërshtatshëm, rreziqeve të ekzagjeruara ose natyrës së papërshtatshme të punës.

Intervistimi i fëmijëve që punojnë

Orientime për mënyrën se si duhet të komunikojnë inspektorët e punës në vendet e punës me fëmijët që punojnë:

Vizita e parë në një vend ku punojnë fëmijë përfshin vëzhgimin e llojit të punës që kryhet, kushtet e sigurisë dhe të shëndetit, oraret dhe pagat, si dhe marrëdhënien e punësimit.

Pasi i bëjnë të ditur menaxhimin ose përfaqësuesit të tij/të saj [ose prindërit të fëmijës ose anëtarëve të tjerë të familjes që mbikëqyrin fëmijën] dhe i paraqesin kredencialet, inspektorët do të duan të flasin me fëmijët për punën e tyre, si



dhe të marrin mendimin e punëtorëve të tjerë. Gjatë intervistës duhet përherë të merret në konsideratë interesi më i lartë i fëmijës.

Disa parime thelbësore, mbi bazën e të cilave duhet të intervistohen fëmijët

- **I fokusuar te fëmija** – Fëmijës duhet t'i jepet informacion, në mënyrë të tillë që ai ose ajo ta kuptojë. Pyeteni fëmijën se ku do të donte të zhvillohej intervista, në çfarë ore, kush do të donte që ta intervistonte dhe kë do të donte të kishte të pranishëm. Kujdesuni që fëmija ta dijë se mund ta ndalojë intervistën në çfarëdoqë momenti, përpikuni të jenë të vëmendshëm ndaj mënyrës se si ndihet fëmija dhe ofroni herë pas here pushime gjatë intervistës.

- **Dhënia e pëlqimit të informuar dhe konfidencialiteti** – Kujdesuni që fëmija ta kuptojë plotësisht qëllimin e intervistës dhe për çfarë po jep pëlqimin. Merrni masat që fëmija ta kuptojë se si do të përdoret informacioni, duke përfshirë edhe rastet kur informacioni mund të përdoret në internet. Flisni me fëmijën për konfidencialitetin e intervistës dhe tregojini se emri dhe informacione të tjera që mund të identifikojnë fëmijën nuk do të përdoren.

- **Të qenit krijues** – A mund të kryhet intervista në mënyra të tjera, përveçse duke u ulur e duke folur? Shumë fëmijëve u pëlqejnë të lëvizin. A ka mënyra ndëraktive dhe kreative për marrjen e informacionit, si për shembull, duke përdorur artin, duke prerë fjalët, shprehjet dhe pohimet nga një tekst që mund t'u vihet në dispozicion?

Udhëzime të mëtejshme dhe të hollësishme për intervistimin e fëmijëve që punojnë

Gjatë intervistimit të fëmijëve që punojnë, është e rëndësishme të mbahet parasysh se nuk është fëmija ai që po shkel ligjin, përkundrazi, mund të jetë punëdhënësi [ose prindi i fëmijës].

Inspektori duhet ta shohë veten në pozicionin që i kërkon fëmijës një favor dhe jo anasjelltas, prandaj, fëmija duhet të shihet si një partner që po eksploron një situatë të veçantë. Në këtë mënyrë, fëmija mund të shohë se çfarë përfiton nga pjesëmarrja në intervistë dhe jo të ndihet i detyruar t'i përgjigjet "kërkesës" për bashkëpunim të inspektorit, gjë që mund ta frikësojë fëmijën.

Nëse fëmija bie dakord të intervistohet, atij/asaj i kërkohet të përshkruajë disa aspekte të përvojës së tij ose të saj – si në mjedisin e punës, ashtu edhe jashtë tij. Duke qenë se inspektori i kërkon fëmijës

ta ndihmojë të kuptojë situatën, intervistuesi duhet të jetë i ndjeshëm ndaj gjendjes emocionale të fëmijës, i vetëdijshëm për pasojat e pyetjeve dhe duhet të respektojë të drejtën e fëmijës për të folur ose për të heshtur.

Në të vërtetë, sidomos në bujqësi, puna e papranueshme e fëmijëve është e prirur të ndodhë në kontekste familjare. Prandaj, gjatë zhvillimit të intervistave me fëmijët në këtë kontekst, është shumë e rëndësishme të kihet parasysh se "punëdhënësi" mund të jetë edhe vetë prindi. Kështu, konteksti psikologjik i fëmijës mund të jetë edhe më i vështirë, ndërkohë që shfrytëzuesi potencial i fëmijës mund të jetë një person që fëmija e do shumë. Inspektorët që kryejnë intervista në këto kontekste duhet, rrjedhimisht, të jenë jashtëzakonisht të ndjeshëm ndaj këtyre çështjeve.

Duke pasur parasysh ndjeshmëritë që shoqërojnë intervistimin e fëmijëve, inspektorët duhet të tregojnë kujdes në kryerjen e këtyre intervistave.

Raportimi dhe regjistrimi i të dhënave

Inspektorati i Punës raporton në Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve dhe në Policinë e Shtetit, mbi të dhënat e mbledhura nga raportet e përvitshme të inspektimit të rasteve të punës së fëmijëve dhe për masat e marra nga ky institucion.

Për përmbushjen e kësaj kërkesë, të gjithë inspektorët e punës duhet të ruajnë me kujdes dhe në mënyrë të sigurt të dhënat për çdo rast të identifikuar, masat mbrojtëse që janë marrë për ndërmjetësimin e këtyre rasteve, si dhe arrijtet, të suksesshme apo jo, si rrjedhojë e këtyre masave. Të dhënat individuale të fëmijëve duhet të përfshijnë të dhëna si:

- *informacion personal (mosha, arsimimi, familja, aktiviteti i fëmijës dhe i prindërve);*
- *vendndodhja e punës (qoftë ajo në shtëpi, në terren, në punishte ose në fabrika);*
- *kushtet e punës (kushtet e punës, si dhe situata në lidhje me shëndetin dhe sigurinë).*

Procesi i monitorimit të punës së fëmijëve duhet të jetë në gjendje të lidhë të dhënat rreth punës me arsimin dhe të verifikojë informacionet për frekuentimin e shkollës me ato informacione nga vizitat monitoruese të zhvilluara në vendin e punës.

Lista e kontrollit të identifikimit të punës së ndaluar të fëmijëve



Siç theksohet në këtë dokument, puna e ndaluar e fëmijëve është ajo punë, që:

- e mban fëmijën jashtë shkollës;
- zgjat për një numër të madh orësh;
- puna, që, në vetvete, kërcënon mirëqenien fizike, emocionale dhe mendore të fëmijës; si dhe
- vendet e punës që përbëjnë rrezik të madh dëmtimi për fëmijën.

Lista e mëposhtme e pyetjeve ka për qëllim të ndihmojë inspektorët e punës të vlerësojnë nëse puna që bën një fëmijë është punë e lejuar apo e ndaluar.

Pyetësi për dokumentacionin që ka punëdhënësi:

- A janë të gjithë punëtorët të dokumentuar nga punëdhënësi?

1. A i ka punëdhënësi të regjistruara emrin, adresën dhe të afërmit e punëmarrësve nën 18 vjeç?

2. A ka punëdhënësi të dhëna për datëlindjen e punëtorëve?

3. A ka punëdhënësi të dhëna mbi kualifikimet relevante të punëtorëve?

4. A ka punëdhënësi të dhëna të regjistruara për pagat e punëtorëve?

- A ka fëmijë të regjistruar si të punësuar në vendin e punës?

1. A ka punëdhënësi ndonjë politikë për menaxhimin e punëtorëve fëmijë?

2. Me çfarë moshe janë të regjistruar punëtorët fëmijë?

3. A ka punëdhënësi autorizim nga Inspektorati i Punës?

4. Në çfarë orarësh punojnë ata?

5. Cilat janë detyrat e tyre?

6. A i përket ndonjë prej këtyre detyrave kategorisë së formave më të rënda të punës së fëmijëve?

Vëzhgimi i vendit të punës

- Cilat janë përshtypjet fillestare për vendin e punës?

- A ka rreziqe të dukshme fizike ndaj punëtorëve?

- A janë zbutur në ndonjë fare mënyrë këto rreziqe fizike?

- Si mbrohen punëtorët fëmijë nga rreziqet fizike të vendit të punës apo nga puna e rrezikshme e papërshtatshme për moshën e tyre?

- Si ndërveprojnë menaxherët me punëtorët?

- A do ta vlerësonit këtë ndërveprim si një ndërveprim me shkallën e duhur të respektit?

- A ka në perceptimin tuaj ndonjë tregues të ngacmimeve seksuale?

- Si ndërveprojnë punëtorët me njëri-tjetrin?

- A ka në perceptimin tuaj bullizëm?

- A ka në perceptimin tuaj ndonjë tregues të sjelljeve të papërshtatshme seksuale?

- Si ndërveprojnë të rriturit me punëtorët fëmijë?

- A ka në perceptimin tuaj bullizëm?

- A ka në perceptimin tuaj ndonjë sjellje seksuale të papërshtatshme, qoftë në ndërveprimet verbale apo fizike në raport me fëmijët në vendin e punës?

Intervistat me punëdhënësit:

1. A ka ndonjë fëmijë (person nën moshën 18 vjeç) që punon këtu? Nëse po:

- Kush janë ata dhe sa vjeç janë?

- A mund të më tregoni më shumë rreth tyre?

2. Sa janë pagat e vendosura për fëmijët, sa shpesh jepen pagat dhe kujt i jepen?

3. Cilat janë përgjegjësitë kryesore të fëmijëve që punojnë këtu?

4. Cilat janë aktivitetet kryesore të familjes suaj për jetesë?

5. Sa e madhe është familja juaj?

6. A mund të më thoni se sa vetë punojnë në familjen tuaj?

- Çfarë pune bën secili prej tyre?

- Sa fiton secili prej tyre?

- Sa shpenzime ka secili anëtar i familjes suaj?

- A ju mungojnë shpesh paratë?

7. Kush i merr zakonisht vendimet financiare në familje?

- A është vendimarrja e ndarë, e përbashkët apo ndryshon?

- Si përdoren paratë?

- Kush merret me blerjen e gjërave që ju nevojiten çdo ditë?

8. A keni qenë ndonjëherë në ndonjë situatë kur juve/një anëtar të familjes suaj ju është kërkuar të punonte falas për të shlyer një borxh?

9. A punon ndonjë nga anëtarët e familjes suaj larg nga shtëpia për të ndihmuar me financat familjare?

10. Si mendoni për punën e fëmijëve?

11. Çfarë lloje punësh janë, për mendimin tuaj, të lejuara dhe çfarë jo?



12. A duhet të bëjnë punë të ndryshme fëmijët në familjes?

- A janë këto përgjegjësi të ndara sipas gjinisë?

13. A ka pasur ndonjëherë ndonjë rast ku një i rritur ose një fëmijë të ketë punuar këtu për të shlyer një borxh. (Shënim. Detyrimi i borxhit është një tregues i sigurt i skllavërisë.)

14. Çfarë mendimi keni për punën e fëmijëve?

15. Çfarë lloj punësh janë, për mendimin tuaj, të lejuara për fëmijët dhe çfarë jo?

Pyetësi për punëmarrësin nën 18 vjeç

Intervistat duhet të jenë gjysmë të strukturuar, d.m.th., inspektori mund të dojë t'i bëjë këto pyetje në forma të ndryshme ose të bëjë pyetje shtesë që mund të lindin nga përgjigjet e marra. Prandaj, pyetjet e mëposhtme janë thjesht pyetje orientuese që kanë për qëllim të ndihmojnë inspektorin për të përcaktuar nëse puna, që bën fëmija është apo jo punë e pranueshme për fëmijët.

- Si e keni emrin?

- Sa vjeç jeni?

- Sa kohë keni që punoni këtu?

- Çfarë përgjegjësisë keni në këtë punë?/Çfarë detyrash duhet të kryeni? (**Kini parasysh, por mos pyesni:** A përputhet ndonjë prej këtyre përgjegjësisë me ato që specifikohen në rekomandimin 190 (1999) të Konventës nr. 182 të ILO-së, si punë e rrezikshme për fëmijët?)

- A ju pëlqen puna që bëni?

- Pse ju pëlqen puna juaj?/Pse nuk ju pëlqen?

- Çfarë vishni normalisht kur punoni?

- A përdorni ndonjë pajisje në punën tuaj? Nëse po, çfarë pajisjesh përdorni?

- Cila është gjëja më e parehatshme që përjetoni në punë?

- Kush ju thotë se çfarë duhet të bëni?

- Çfarë mendoni për faktin që punoni?

- A mendoni se puna juaj është e rrezikshme?

- A jeni plagosur/dëmtuar ndonjëherë në punë? (Nëse po: Si ndodhi kjo?)

- A ka ndonjë person në punë që jua bën gjërat e vështira apo që tallet me ju?

- A ka ndonjë njeri në punë, të cilit/së cilës mund t'i kërkonti ndihmë nëse gjërat janë të vështira?

- Kur punoni këtu? (Për shembull, gjatë pushimeve, fundjavave, pas shkollës?)

- Sa orë punoni normalisht këtu?/ (Për shembull, një apo dy orë pas disa ditësh shkollë,

apo është punë me kohë të plotë, duke përjashtuar shkollën?)

- Sa paguheni?

- Sa shpesh paguheni?

- A keni pushime gjatë punës?

- Në çfarë shkolle shkoni?

- Ku jetoni?

- Me kë jetoni?

- A kryeni ndonjë aktivitet në punën tuaj apo a ka ndonjë kusht pune me të cilin nuk keni rënë dakord?

- Nëse do të donit të mos punonit më këtu, a do të mund ta linin punën?

(Shënim. Nëse fëmija është i ndarë nga prindërit dhe punon në një situatë pune të papranueshme për fëmijët, ata mund të jenë viktimë e skllavërisë së fëmijëve dhe jo thjesht e punës së papranueshme për fëmijë?)

Intervistat me prindërit e fëmijëve që punojnë (në varësi të situatës, kur japin pëlqimin):

1. Cilat janë aktivitetet kryesore të familjes suaj për jetesë?

2. Sa e madhe është familja juaj?

3. A mund të më thoni se sa vetë punojnë në familje tuaj?

- Çfarë pune bën secili prej tyre?

- Sa fiton secili prej tyre?

- Çfarë shpenzimesh ka çdo pjesëtar i familjes?

- A ju mungojnë shpesh paratë?

4. Kush i merr zakonisht vendimet financiare në familje?

- A është vendimmarrja e ndarë, e përbashkët apo ndryshon?

- Si përdoren paratë?

- Kush merret me blerjen e gjërave që ju nevojiten çdo ditë?

5. A keni qenë ndonjëherë në ndonjë situatë, kur juve/një anëtar të familjes suaj ju është kërkuar të punonte falas për të shlyer një borxh?

6. A punon ndonjë nga anëtarët e familjes suaj larg nga shtëpia për të ndihmuar me financat familjare?

7. Çfarë mendoni për punën e fëmijëve?

8. Çfarë lloje punësh janë, për mendimin tuaj, të lejuara dhe çfarë jo?

9. A duhet të bëjnë punë të ndryshme fëmijët në familje?



- Nëse po, çfarë lloj punësh? Për sa kohë duhet t'i bëjnë ato?

- A janë detyrat specifike të ndara sipas gjinisë?

VENDIM

Nr. 480, datë 17.6.2020

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 387, DATË 13.5.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E GARANCISË SHTETËRORE TË HUAS ME BANKAT TREGTARE, PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE TREGTARE, PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E NEVOJSHËM PËR RIMËKËMBJEN E AKTIVITETIT TREGTAR TË NDIKUAR NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID-19, SI EDHE PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE DHE KRITEREVE TË MARRËVESHJES SË GARANCISË DHE MARRËVESHJES SË MIRËKUPTIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3 e 38, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 57, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në marrëveshjen e garancisë (Format tip), bashkëlidhur vendimit nr. 387, datë 13.5.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ndryshimi, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të reflektohet në marrëveshjet e garancisë së lidhura me bankat tregtare, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

Këshilli i Ministrave

Përfaqësuar nga

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____, 2020
[Banka XYZ]

Nr. _____ prot.
Tiranë, më _____, 2020

PËR NJË NDRYSHIM NË MARRËVESHJEN E GARANCISË “PËR GARANTIMIN E HUAMARRJES SË TREGTARËVE OSE SHOQËRIVE TREGTARE, PËR TË MUNDËSUAR FINANCIMIN E NEVOJSHËM PËR RIMËKËMBJEN E AKTIVITETIT TREGTAR TË NDIKUAR NGA SITUATA E KRIJUAR NGA COVID-19”

(FORMAT TIP)

[xxxxxxx] lekë

Data e hyrjes në fuqi
[_____]

1. Neni 7, ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 7

(Rekuperimi post-pagesës së garancisë)

1. Me kryerjen e pagesës së garancisë për ndonjë prej Huave, MFE-ja merr në dorëzim menjëherë të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore, që zotëronte Huadhënësi ndaj Huamarrësit, sipas përcaktimeve të Marrëveshjes së Huasë dhe në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja në kuadër të garancisë për këtë Hua. Këto të drejta dhe mjete ligjore i kalojnë MFE-së, së bashku me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

2. MFE-ja, nëpërmjet kësaj marrëveshje, autorizon Huadhënësin që të ndjekë, në emër dhe për llogari të MFE-së, të gjitha procedurat e rekuperimit të detyrimeve, në përputhje me procedurat ligjore dhe praktikën e sektorit bankar, për të gjithë shumën e detyrimit të Huamarrësit.

Në çdo rast Huadhënësi merr përsipër të kryejë të paktën të njëjtat procedura për rekuperimin e



detyrimit, ashtu si për detyrimin e vetë Huadhënësit.

Huadhënësi është i detyruar të njoftojë menjëherë MFE-në për çdo veprim procedural të kryer gjatë procedurës së ekzekutimit vullnetar ose të detyrueshëm, me qëllim që të mos cënohen të drejtat materiale apo procedurale të MFE-së.

Përfundimisht, palët, me marrëveshje të veçantë, mund të bien dakord që të heqin dorë nga ndjekja e procedurave për ekzekutimin e detyrimit, në rastet kur vlerësojnë se kostot e këtyre procedurave tejkalojnë masën e të gjithë detyrimit.

3. Nëse pas 2 (dy) viteve nga data e kryerjes së Pagesës së Garancisë, Huadhënësi nuk ka mundur të recuperojë detyrimet e Huamarrësit, MFE-ja zotëron të drejtën që të ndjekë vetë procedurat ligjore për recuperimin e detyrimeve, në masën e çdo pagese të kryer nga MFE-ja, në kuadër të garancisë për këtë Hua, në përputhje me të drejtat dhe mjetet ligjore që ka në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

4. Nëse pas pagesës së garancisë nga MFE-ja për ndonjë prej Huave, Huadhënësi, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, recuperon një pjesë ose të gjithë detyrimin e Huasë (duke përfshirë edhe recuperimin nëpërmjet ekzekutimit të kolateralit, nëse ka një të tillë) që paraprakisht është paguar nga garancia, Huadhënësi brenda një afati prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune duhet të njoftojë me shkrim MFE-në në lidhje me vlerën e recuperuar, procedurat e recuperimit, shpenzimet e recuperimit dhe çdo detaj tjetër që gjykon të arsyeshëm në lidhje me recuperimin.

Menjëherë pas marrjes së njoftimit, MFE-ja udhëzon me shkrim Huadhënësin në lidhje me detajet e pagesës. Afati për kryerjen e pagesës nga Huadhënësi në favor të MFE-së do të jetë si më poshtë:

a) Në rastin kur recuperimi është në formën e mjeteve monetare (cash), pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e marrjes së instruksioneve me detajet e pagesës nga MFE-ja.

b) Në rastin kur recuperimi nuk është në formën e mjeteve monetare, pagesa do të kryhet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga data e konvertimit të recuperimit në mjete monetare (cash). Konvertimi i recuperimit në mjete monetare (cash) do të kryhet në përputhje me procedurat dhe politikat e Huadhënësit për këtë qëllim.

5. Vlera që Huadhënësi paguan në favor të MFE-së, në rast të recuperimit të detyrimit të Huamarrësit nga Huadhënësi pas Pagesës së Garancisë, është e barabartë me vlerën e recuperuar pasi t'i jenë zbritur principlali dhe interesi i papaguar ndaj Huadhënësit, si dhe shpenzimet për recuperimin e Huasë.

6. Në rast se Huamarrësi, përveç detyrimit që buron nga Huaja nën këtë Marrëveshje Garancie, ka edhe detyrime të tjera ndaj Huadhënësit, atëherë ndjekja e detyrimit që buron nga kjo Hua ndiqet njëkohësisht me ndjekjen e detyrimeve të tjera, pa asnjë lloj diskriminimi nga Huadhënësi.”

2. Të gjitha nenet e tjera të kësaj Marrëveshje, mbeten të pandryshuara.

KËSHILLI I MINISTRAVE
PËRFAQËSUAU NGA
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

MINISTËR
[EMËR MBIEMËR]

BANKA [XYZ]
ADMINISTRATOR

[EMËR MBIEMËR]

VENDIM
Nr. 484, datë 17.6.2020

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKET NGA PROJEKTI “KRIJIMI I
QENDRAVE TË FSHATRAVE, ME
SIPËRFAQE QËNDRIMI, PUSHIMI,
PARKIMI DHE LULISHTEJE, NË
FSHATIN MBRAKULL”, POLIÇAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga projekti “Krijimi i qendrave të fshatrave, me sipërfaqe qëndrimi, pushimi, parkimi dhe lulishteje, në fshatin Mbrakull”, Poliçan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Poliçan.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit tokë “arë” + “truall” + “ndërtesë”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 664 617 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 664 617 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e shtatëmbëdhjetë) lekësh, të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Poliçan.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2020, i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronari i pasurisë së paluajtshme, pronë private, i pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Poliçan.

8. Bashkia Poliçan të kryejë procedurat për likuidimin e pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Poliçan.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Poliçan, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të shtetit.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit për pasurinë e shpronësuar.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat dhe Bashkia Poliçan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



LISTA E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI “KRIJIMI I QENDRAVE TË FSHATRAVE ME SIPËRFAQE QËNDRIMI, PUSHIMI, PARKIMI DHE LULISHTEJE, NË FSHATIN MBRAKULL”, POLIÇAN

Nr.	Emër Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqe shpronësimi			Çmimi (lek)		Vlera e tokës arë (lek)	Vlera e tokës truall (arë)	Vlera e ndërtimit (lek)	Vlera totale / lek	Shënime, konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
					Tokë arë (m ²)	Tokë truall (m ²)	Sip. ndërtese (m ²)	Tokë arë (m ²)	Tokë truall (m ²)					
1	Kosta Ilias Mile	2632	100/16	500	250	250	80	203	189	50750	47250	1,566,617.00	1,664,617.00	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit													1,664,617.00	

**VENDIM****Nr. 485, datë 17.6.2020**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA
REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I
DY FIDERAVE TË RINJ KABLLORË,
FIDERI F9 DHE FIDERI F10, ME
IZOLACION 20 kV, NËNSTACIONI I RI
110/20 kV, PLASTMASA, LUSHNJË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i dy fiderave të rinj kabllorë, fideri F9 dhe fideri F10, me izolacion 20 kV, nënstacioni i ri 110/20 kV, Plastmasa, Lushnjë”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.).

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit tokë “arë” dhe tokë “truall”, me vlerë 26 407.92 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 26 407.92 (njëzet e gjashtë mijë e katërqind e shtatë pikë nëntëdhjetë e dy) lekë, të përballohet nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë tre muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, pranë Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.).

8. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) të kryejë procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga OSHEE sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në bashkëpunim me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.), brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjë kalimin e pronësisë në favor të OSHEE sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar, deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të OSHEE sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**



LISTA E PRONARËVE TË PASURIVE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT: “NDËRTIMI I DY FIDERAVE TË RINJ KABLLORË, FIDERI F9 DHE FIDERI F10, ME IZOLACION 20 kV, NËNSTACIONI I RI 110/20 kV, PLASTMASA, LUSHNJË”

Për truallin dhe tokën arë, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.

Nr.	Emër, Mbiemër	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale (m ²)	Sipërfaqja shpronësimit (m ²)		Çmimi		Vlera totale/lekë	Shënime konfirmuar ose jo nga ZVRPP-ja
					Tokë arë	Tokë truall	Tokë arë /m ²	Tokë truall /m ²		
1	Bashkim Elmaz Kasapi	2087	639/5	1700	9.24		364		3,363.36	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Izet Tafil Kasapi	2087	635/46	1800		9.24		2,130	19,681.20	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Lefter Nurce Shakaj	2087	617/7	750	9.24		364		3,363.36	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
Vlera totale e shpronësimit									26,407.92	

VENDIM

Nr. 486, datë 17.6.2020

PËR SHTYPJEN, BOTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË SISTEMIT TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria përgjegjëse për arsimin miraton dhe certifikon tekstet shkollorë të arsimit parauniversitar, të cilat konkurrojnë, në barazi të plotë, në përzgjedhje nga përdoruesit. Kriteret dhe procedurat e konkurrimit e të përzgjedhjes përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Procesi i shtypjes, botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollorë të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve e të procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Shpenzimet për tekstet shkollorë të dërguara në institucionin arsimor ose Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar (në vijim ZVAP) për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese.

3. Tekstet shkollorë shpërndahen/shiten në mjediset shkollorë. Drejtoritë e institucioneve arsimore ofrojnë një ose dy mjedise shkollorë, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në institucionin arsimor në fjalë.

4. Çmimi i shitjes është ai i vendosur në kopertinën e tekstit shkollor të certifikuar. Çmimet e teksteve shkollorë, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, indeksohen çdo vit, në përputhje me rritjen e inflacionit, të publikuar nga INSTAT-i.

5. Tekstet duhet të jenë të pajisura me pullën me hologramë të certifikimit, të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Pulla me hologramë u shitet botuesve nga ministria përgjegjëse për arsimin, kundrejt pagesës. Tekstet, që tregtohen pa këtë pullë, i nënshtrohen procesit të konfiskimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Kategoritë që do të përfitojnë mbështetje buxhetore për kompensimin në masën 100% të çmimit të teksteve shkollorë janë, si më poshtë vijon:

6.1 Nxënësit në arsimin bazë që:

a) i përkasin kategorisë së pakicave kombëtare;
b) janë fëmijë, i tretë e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje.

6.2 Nxënësit në arsimin parauniversitar që:

a) kanë përfituar statusin e jetimit;
b) vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike dhe pagesë papunësie nga zyrat e punësimit;

c) janë me aftësi të kufizuara, sipas ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

ç) vijnë nga familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë, sipas ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;



d) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension invaliditeti shteti;

dh) vijnë nga familje ku kryefamiljari përfiton pension pleqërie shteti dhe kanë fëmijë në ngarkim, të cilët janë pa të ardhura;

e) i përkasin kategorisë rome dhe egjiptiane. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të këtyre kategorive. Mënyra e shpërndarjes së teksteve, për këto kategori nxënësish, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin;

ë) gëzojnë statusin e të verbrit. Nxënësit pajisen me tekste shkollore të transkriptuara në shkrimin *brail*, të regjistruara në audio ose në shkrim të zmadhuar, të cilat janë pronë e shkollës. Administrimi i kërkesave për prodhimin/shumëfishimin e teksteve në *brail* dhe në shkrim të zmadhuar literal, si dhe pajisja me libra e nxënësve të verbër të realizohen nga Instituti i Nxënësve që nuk Shikojnë, në Tiranë. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie;

f) janë viktimat të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme;

g) gëzojnë statusin e viktimës dhe të viktimës së mundshme të trafikimit, në përputhje me vendimin nr. 499, datë 29.8.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

gj) janë të moshës shkollore të arsimit parauniversitar, të cilët janë në institucionet e paraburgimit/vuajtjes së dënimit;

h) janë të shtruar në Shërbimin Onkologjik, në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Kërkesa dhe sasia për tekstet shkollore dërgohet nga ky shërbim në muajin gusht të çdo viti;

i) janë fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të

Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;

j) janë përfitues në institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës. Drejtoritë përkatëse të institucioneve arsimore, ku mësojnë këta nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në ZVAP-të përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

6.3 Nxënësit që ndjekin arsimin bazë, në klasën e parë, në institucionet arsimore publike, të cilëve u jepen tekstet shkollore të reja, çdo vit, në përdorim falas. Nxënësve, që ndjekin arsimin bazë në institucionet arsimore publike nga klasa e dytë deri në klasën e shtatë, u jepen tekstet shkollore në përdorim falas. Institucionet arsimore publike, si dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar, brenda muajit korrik të çdo viti, përgatisin listën e parashikuar të teksteve për përdorim falas dhe të reja, nga klasa e parë deri në klasën e shtatë.

Blerja e teksteve të reja shkollore të nxënësve që ndjekin arsimin bazë, nga klasa e parë deri në klasën e shtatë, në institucionet arsimore publike, në emër të prindërve ose të përfaqësuesve ligjorë, për llogari të nxënësve, realizohet nga institucioni arsimor publik, për llogari të zyrës vendore të arsimit parauniversitar.

Likuidimi i faturës tatimore ndaj shtëpive botuese dhe/ose distributorëve realizohet nga zyra vendore e arsimit parauniversitar, me fondet e miratuara si “Transfertë tek individët”, në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në llogarinë bankare të shitësit. Mënyra e shpërndarjes dhe e administrimit të teksteve, për këtë kategori nxënësish, përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për arsimin.

7. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore për kategoritë e përcaktuara në këtë vendim mbulohet nga buxheti i ministrisë përgjegjëse për arsimin, në formën e “Transfertës tek individët” dhe “Transfertës të shtëpitë botuese”, sipas rastit, në masën 100% të tij.



8. Shitja e teksteve shkollore bëhet përkundrejt faturave. Për kategoritë e nxënësve, që përfitojnë sipas pikës 6 të këtij vendimi, pagesa bëhet nëpërmjet llogarive buxhetore të ZVAP-ve ose të vetë institucionit arsimor, kur ka llogari të tillë, me fondet e miratuara si “Transferte tek individët” në buxhetin e ministrisë përgjegjëse për arsimin.

9. Procedurat e përdorimit dhe të shpërndarjes së fondeve buxhetore për blerjen e teksteve shkollore, si dhe mënyra e pagesës për kategorinë e nxënësve përfitues përcaktohen me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për financat dhe të ministrit përgjegjës për arsimin.

10. Vendimi nr. 107, datë 10.2.2010, i Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar, shfuqizohet.

11. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 488, datë 17.6.2020

**PËR SHPËRNDARJEN DHE
DETAJIMIN E FONDIT PREJ 950 295 959
LEKËSH, NË PROGRAMIN
“MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË
UJITJES DHE TË KULLIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërndarjen dhe detajimin e fondit prej 950 295 959 (nëntëqind e pesëdhjetë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e nëntë) lekësh, në programin “Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe të kullimit”, për projektet e ujitjes, sigurinë e digave dhe mbrojtjes nga përmytja, sipas bashkive, përcaktuar në tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Projektet për rehabilitimin e digave, para fillimit të procedurës së prokurimit, të jenë të miratuara në Komitetin Kombëtar të Digave të Mëdha.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama



Tabela 1. Lista e projekteve

Nr.	Institucioni përfitues	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit në lekë	Financimi për vitin 2020	Financimi i parashikuar për vitin 2021
		Totali	1,620,687,893	950,295,959	670,391,933
		Objekte në vazhdim <i>(Financuar pjesërisht gjatë vitit 2019 me VKM nr.170, datë 27.3.2019, "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1 000 000 000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", të ndryshuar)</i>	638,942,812	638,942,812	0
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>		191,685,054	0
1	Bashkia Krujë	Rehabilitimi digës së ujëmbledhësit Tapizë		24,444,551	
2	Bashkia Mat	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Shoshaj		22,953,070	
3	Bashkia Roskovec	Rehabilitim i ujëmbledhësit Kurjan		10,352,335	
4	Bashkia Kamëz	Rezervuari Paskuqan		38,865,896	
5	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i digës së rezervuarit Kuka		19,069,255	
6	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Arapaj 1		29,945,787	
7	Bashkia Durrës	Rehabilitimi i digës së ujëmbledhësit Spitalë		20,054,160	
8	Bashkia Rrogozhinë	Rehabilitimi i digës dhe skemës ujitëse të rezervuarit të Okshtunit		26,000,000	
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja</i>		447,257,758	0
1	Bashkia Elbasan	Përroi Zaranikës		86,495,097	
2	Bashkia Fier	Dega Ujitëse e Fierit		8,930,576	
3	Bashkia Divjakë	Skema ujitëse-Sektori i Ri në Xeng		41,861,325	
4	Bashkia Kolonjë	Kanali ujitës Kabash, Leskovik		4,941,538	
5	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i pjesshëm i Degës Ventrok		7,918,633	
6	Bashkia Mirditë	Rehabilitim i skemës ujitëse ujëmbledhësi Malaj-2 (Faza 3)		27,212,647	
7	Bashkia Malësi e Madhe	Skeme ujitëse me rehabilitimin e kanaleve sekondare të Shtodrit, Loti 2		11,482,904	
8	Bashkia Pukë	Rehabilitimi i Kanalit Vadtës fshati Qerret		8,784,266	
9	Bashkia Shijak	Rehabilitimi i Kanalit Ujitës Hardhishtë-Rreth		38,229,893	
10	Bashkia Belsh	Kanali i Ujitjes Çerrage		23,278,603	
11	Bashkia Gramsh	Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat-Cingar Sipër-Drizë		14,081,687	
12	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës Gurakuq Kuturman, (Loti I-rë ndërtimi i Sifonit të Madh)		16,627,253	
13	Bashkia Këlcyrë	Skema Ujitëse Ballaban, Ujitja e Fushës Ballaban, vazhdim		17,385,008	
14	Bashkia Bulqizë	Rikonstruksion i Kanalit Ujitës Vija e Mullirit Gjoricë		22,800,328	
15	Bashkia Dibër	Kanali ujitës Përroi i Lixhave Lagjia Dobrovë		5,787,096	
16	Bashkia Dibër	Sifoni ujitës dalja e rezervuarit Shumbat		6,633,317	
17	Bashkia Kukës	Rehabilitim i kanalit ujitës Bushat, Njësia Administrative Bicaj Bashkia Kukës		4,684,253	
18	Bashkia Roskovec	Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut		35,240,203	
19	Bashkia Lushnjë	Rehabilitimi i kanalit ujitës U.3-15, U.3-15/4, U.3-15/5 në fshatin Fier i Ri, Nj.Ad. Krutje		2,895,288	
20	Bashkia Ura Vajguore	Kanali Ujites BRU-15 Manastir & Ushqyesi i Rezervuarit		7,714,000	
21	Bashkia Cërrik	Rehabilitim Sistemi Ujitjes		12,947,338	
22	Bashkia Fushë Arrëz	Rikonstruksion i kanalit fshati Iballë		14,761,955	
23	Bashkia Përmet	Kanali Strembec		7,044,828	



24	Bashkia Libohovë	Rehabilitimi i skemës ujitëse të Bulos si dhe kanalit kullues K-1-76 Fushë Nepravishtë		19,334,085	
25	Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit Fier	Mbrojtje nga Lumi Vjosë, në Kashisht		185,637	
		Objekte të rinj	981,745,080	311,353,147	670,391,933
		<i>Projekte për rehabilitimin e digave</i>	195,380,297	56,231,733	139,148,564
1	Bashkia Dibër	Rehabilitimi i Digës së Gramës	56,911,841	13,000,000	43,911,841
2	Bashkia Shijak	Ndërtimi i shkarkuesve katastrofik në rezervuare	3,231,733	3,231,733	
3	Bashkia Kamëz	Rehabilitimi i Digës së Rezervuarit Paskuqan (faza e dytë)	52,462,000	12,000,000	40,462,000
4	Bashkia Dropull	Rehabilitimi i digave të ujëmbledhësve të bashkisë Dropull (Kakavijë, Likomil, Peshkëpi dhe Bodrisht) dhe kanalit ujitës i rezervuarit të Peshkëpisë	35,927,723	13,000,000	22,927,723
5	Bashkia Tiranë	Reabilitim i mekanizmit të komandimit të portave të ujëlëshuesit dhe shkarkuesit katastrofik anësor të rezervuarit Gjyslikonje.	46,847,000	15,000,000	31,847,000
		<i>Projekte për infrastrukturën e ujitjes</i>	786,364,783	255,121,414	531,243,369
1	Bashkia Tepelenë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Dukaj	21,600,000	10,000,000	11,600,000
2	Bashkia Sarandë	Rehabilitimi i kanalit ujitës Ksamil, pjesa e I	32,858,207	10,000,000	22,858,207
3	Bashkia Mallakastër	Rehabilitimi i rrjetit ujitës Çorush	35,006,071	11,000,000	24,006,071
4	Bashkia Fier	Dega e Martinës	40,966,000	10,000,000	30,966,000
5	Bashkia Vau i Dejës	Ku-13, Shelqet , Vau i Dejës	13,740,541	10,000,000	3,740,541
6	Bashkia Klos	Rikonstruksion kanali vaditës Cerujë	3,736,400	3,736,400	
7	Bashkia Selenicë	Rehabilitim i kanalit vaditës rezervuari Harvala, rikonstruksioni i kanalit në pjesën e parë nga dalja e ujëlëshuesit të rezervuarit, deri në progresivin 1800 ml	22,137,547	10,000,000	12,137,547
8	Bashkia Shijak	Rehabilitimi sistemit ujitës Nj.A Gjepale	14,983,766	10,000,000	4,983,766
9	Bashkia Devoll	Pellgu ujëmbledhës, kanali i furnizimit me ujë të rezervuarit në qytetin e Bilishtit	26,792,502	10,000,000	16,792,502
10	Bashkia Skrapar	Mbrojtje nga lumi Guak në krahun e majtë në zonën e Verorit, Çorovodë	22,963,658	22,963,658	-
11	Bashkia Lezhë	Kanali ujitës Kotërr- Rrabosht, segmenti Kotërr-Nënshat (L=1000m) dhe segmenti Pirraj Rrabosht (L=2150m)	46,199,992	15,000,000	31,199,992
12	Bashkia Librazhd	Rikonstruksion i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz, Librazhd	62,179,787	19,200,600	42,979,187
13	Bashkia Përmet	Ndërtim i rrjetit ujitës Bodar-Kutal	26,559,105	10,000,000	16,559,105
14	Bashkia Lushnje	Rehabilitimi i kanalit ujitës U3-27, V-1/1 në fshatin Bishtqethën dhe Bitaj, NjA Kolonjë	28,597,408	10,000,000	18,597,408
15	Bashkia Gjirokastër	Rikonstruksioni i kanalit vaditës Zhulat	67,638,000	15,220,756	52,417,244
16	Bashkia Bulqizë	Kanali ujitës Tuçep, Bulqizë	129,746,000	27,000,000	102,746,000
17	Bashkia Cërrik	Rehabilitimi i kanaleve vaditës e kullues Bashkia Cërrik	41,200,000	12,000,000	29,200,000
18	Bashkia Kolonjë	Rikonstruksioni i rrjetit ujitës të rezervuarit të Gjonçit, bashkia Kolonjë	75,894,848	21,000,000	54,894,848
19	Bashkia Prenjas	Rehabilitimi Skemes Ujitese Radigos-Stranik-Berezeshte	73,564,951	18,000,000	55,564,951

**VENDIM****Nr. 489, datë 17.6.2020****PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË BANESAVE
INDIVIDUALE DHE NJËSIVE TË
BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) NË
BASHKITË KAMZË DHE KAVAJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën prej 510 240 000 (pesëqind e dhjetë milionë e dyqind e dyzet mijë) lekësh, për financimin e rikonstruksionit të banesave individuale dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ato individë të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në Bashkitë Kamzë dhe Kavajë.

2. Efekti financiar sipas pikës 1 të përballohet nga pjesa e financuar nga grantet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2020, dhe t’u kalojë bashkive Kamzë dhe Kavajë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi prej 163 890 000 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi prej 346 350 000 (treqind e dyzet e gjashtë milionë e treqind e pesëdhjetë mijë) lekësh, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe

Ekonomisë dhe bashkitë Kamzë dhe Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM**Nr. 16, datë 12.6.2020****PËR NJË NDRYSHIM NË
UDHËZIMIN NR. 28, DATË 12.12.2019,
“PËR ORGANIZIMIN DHE
ZHVILLIMIN E PROVIMEVE
KOMBËTARE TË MATURËS
SHTETËRORE 2020”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 26 dhe 51, të ligjit nr. 69, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në pikën 8, të udhëzimit nr. 28, datë 12.12.2019, togfjalëshi “... dhe zgjasin 2 orë.” zëvendësohet me togfjalëshin “... dhe zgjasin 2 orë e 30 minuta.”.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini



UDHËZIM
Nr. 24, datë 16.6.2020

**PËR REGJISTRIMIN E PAGESAVE TË
FATURAVE ELEKTRONIKE**

Në zbatim të nenit 102, paragrafi 4, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 37 dhe të pikës 2, të nenit 47, të ligjit nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, udhëzoj:

Neni 1
Qëllimi i udhëzimit

Ky udhëzim përcakton elementet teknike të regjistrimit të pagesave të faturave elektronike, siç përcaktohet nga ligji nr. 87/2019, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” (më tej referuar si “ligji”), për transaksionet pa para në dorë midis tatimpaguesve dhe transaksionet pa para në dorë midis tatimpaguesve dhe organeve publike.

Neni 2
**Njoftimi për pagesat e faturave
elektronike**

1. Sipas nenit 37, të ligjit, bankat, institucionet e tjera financiare jobankare dhe subjekte të tjera, të cilat ofrojnë shërbime të pagesave pa para në dorë, detyrohen të regjistrojnë dhe të informojnë administratën tatimore për çdo pagesë të kryer gjatë çdo dite pune, në emër dhe për llogari të klientëve të tyre.

2. Njoftimi i përmendur në pikën 1 të këtij neni bëhet vetëm për pagesa të faturave elektronike, të lëshuara në transaksione midis dy tatimpaguesve ose ndërmjet një tatimpaguesi dhe një organi publik.

3. Njoftimi bëhet me mjete elektronike, përmes lidhjes në internet me sistemin e informacionit të administratës tatimore, deri në fund të çdo dite pune dhe këto të dhëna duhet të kenë informacion të veçantë për secilën faturë të paguar dhe shumën që është paguar.

4. Pas marrjes së urdhrat të pagesës, banka ose institucioni tjetër financiar jobankar verifikon nëse janë paraqitur të gjithë të dhënat sipas pikës 3, të nenit 4, të këtij udhëzimi dhe nuk ka

detyrimin për të kontrolluar saktësinë e këtyre të dhënave të paraqitura.

Neni 3
**Detyrime të institucionit që ofron
shërbime të pagesave**

1. Pasi të kryhet pagesa, banka ose institucioni tjetër financiar jobankar ka detyrimet e mëposhtme:

a) pika e hyrjes së bankës ose e institucionit tjetër financiar jobankar (që mund të jetë pajisja elektronike e përdorur ose sistemi i informacionit i përdorur, që do të thotë zgjidhja e certifikuar *software*-ike e përdorur) përgatit informacionin për pagesat dhe mesazhin e kërkesës XML dhe e nënshkruan atë elektronikisht me çelësin privat të certifikatës elektronike;

b) pika e hyrjes inicion një komunikim të sigurt me një drejtim, përmes të cilit serveri i administratës tatimore e paraqet veten me certifikatën e serverit;

c) pasi të vendoset me sukses komunikimi i sigurt, bëhet një thirrje e shërbimit të fiskalizimit;

ç) sistemi i informacionit i administratës tatimore merr dhe përpunon mesazhin e kërkesës. Nëse kërkesa përpunohet me sukses, ky sistem përgatit një mesazh përgjigjeje XML, e nënshkruan në mënyrë elektronike me çelësin privat të certifikatës elektronike dhe ia dërgon bankës ose institucionit tjetër financiar jobankar;

d) pika e hyrjes së bankës ose e institucionit tjetër financiar jobankar merr një mesazh përgjigjeje dhe verifikon nënshkrimin elektronik me çelësin publik të aplikacionit të certifikatës elektronike;

dh) banka ose institucioni tjetër financiar jobankar ruan mesazhin e marrë në format elektronik.

2. Të dhënat, të cilat për nevoja të regjistrimit të pagesave i dërgohen Administratës Tatimore Qendrore, sipas mënyrës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duhet të përmbajnë të paktën, elementet e mëposhtme:

a) numrin unik të identifikimit të subjektit pagues (NUIS/NIPT të blerësit të mallrave ose shërbimeve);

b) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS/NIPT) që ofron shërbimet e pagesës;



c) NIVF-në (Numri Identifikues i Veçantë i Faturës) e faturës së paguar apo në raste të veçanta NSLF-në (Numri i Sigurisë së Lëshuesit të Faturës), nëse në faturë nuk ka NIVF, në përputhje me nenin 29 të ligjit;

ç) shumën e paguar;

d) datën e pagesës.

3. Pas marrjes së mesazhit nga banka ose institucioni tjetër financiar jobankar, administrata tatimore kryen verifikimet e mëposhtme:

a) verifikimi i autorizimit (verifikimi i nënshkrimit elektronik dhe verifikimi i certifikatës elektronike);

b) verifikimi i formalitetit (verifikimi i mesazhit XML, në lidhje me skemën e përshkruar XML, përfshirë verifikimin nëse dërguesi i mesazhit ka plotësuar të gjithë elementet e kërkuar nga skema);

c) verifikimi i përmbajtjes, që përfshin:

i. verifikimin e NIPT-it të pagesit. Paguesi konsiderohet të jetë blerësi ose tatimpaguesi tjetër, i cili është i detyruar të paguajë faturën elektronike të lëshuar për furnizimin e mallrave ose shërbimeve;

ii. verifikimin e NIPT-it të bankës ose institucionit tjetër financiar jobankar;

iii. verifikimin e NIVF-së ose NSLF-së të faturës elektronike të paguar;

iv. verifikimin e shumës së paguar në krahasim me shumën e deklaruar në faturë etj.

4. Sistemi i informacionit të administratës tatimore kthen një mesazh përgjigjeje XML në pikën e hyrjes së bankës ose të institucionit tjetër financiar jobankar, që përmban përshkrimin e gabimit, nëse pas përpunimit të mesazhit të kërkesës, sipas pikës 1 të këtij neni, ndodhin gabimet si më poshtë:

a) gabimi i sistemit gjatë përpunimit të kërkesës;

b) ndonjë gabim teknik ose;

c) gabimi ka të bëjë me certifikatën elektronike.

Nëse konstatohet ndonjë gabim si rezultat i përgjegjësisë së bankës ose i institucionit tjetër financiar jobankar, banka ose institucioni tjetër financiar jobankar detyrohet të korrigjojë gabimin dhe të përsërisë procedurën. Nëse gabimi nuk është shkaktuar nga banka ose institucioni tjetër financiar jobankar, banka ose institucioni tjetër financiar jobankar duhet të

informojë pagesin/blerësin për gabimin, brenda 24 orëve nga marrja e mesazhit.

5. Nëse pagesi nuk është klient i bankës ose i institucionit tjetër financiar jobankar, që ka kryer pagesën, atëherë banka ose institucioni tjetër financiar jobankar nuk ka asnjë detyrim për njoftimin e gabimit të hasur gjatë procedurës së verifikimit nga administrata tatimore.

6. Nëse NIPT-i i pagesit të paraqitur është i saktë, sistemi i informacionit i Administratës Tatimore i dërgon mesazh gabimi pagesit /blerësit në llogarinë e tij të përdoruesit në platformën qendrore të faturave. Paguesi/blerësi është i detyruar të korrigjojë gabimin dhe të informojë për këtë bankën ose institucionin tjetër financiar jobankar, që ofron shërbime pagese, në mënyrë që të përsëritet procedura e parashikuar në pikën 3, të nenit 2, të këtij udhëzimi.

7. Sipas ligjit, nuk ka asnjë kufizim mbi sasinë e pagesave për secilën faturë elektronike (për shembull, nëse blerësi paguan vetëm një pjesë të shumës së faturës) dhe as mbi pagesat në grup të disa faturave të lëshuara nga i njëjti tatimpagues, por banka ose institucioni tjetër financiar jobankar duhet të njoftojë administratën tatimore për shumën e saktë të paguar për çdo faturë në çdo ditë.

8. Nëse pagesa është shlyer nga banka qendrore (blerësi dhe shitësi përdorin banka të ndryshme), detyrimi për të raportuar pagesën e faturës është për bankën dërguese ose institucionin tjetër financiar jobankar dërgues, pra për bankën ose për institucionin tjetër financiar jobankar që dërgon pagesën dhe jo për bankën ose institucionin tjetër financiar jobankar që e pranon atë.

9. Në rast të transferimeve hyrëse ndërkombëtare, nuk ka asnjë detyrim për raportimin e pagesave, pasi detyrimi i njoftimit përcaktohet vetëm për bankën ose institucionin tjetër financiar jobankar që bën pagesën dhe jo për atë që e merr.

Neni 4

Detyrime të tatimpaguesit që merr apo kryen pagesa

1. Nëse tatimpaguesi merr pagesë për një faturë elektronike të lëshuar dhe kjo pagesë nuk është raportuar në administratën tatimore nga



banka ose institucioni tjetër financiar jobankar, për arsye të ndryshme (për shembull, pagesa nuk është kryer përmes llogarisë bankare ose ka pasur një gabim gjatë verifikimit të administratës tatimore të mesazhit të marrë, ose për arsye të parashikuara në pikën 8, të nenit 37, të ligjit), tatimpaguesi që ka lëshuar faturën elektronike regjistron vetë pagesën e marrë, duke përdorur platformën qendrore të faturave në llogarinë e tij të përdoruesit, por jo më vonë se data 10 e muajit vijues.

2. Tatimpaguesi që lëshon fatura procedon sipas mënyrës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, edhe në rast të realizimit të pagesës përmes kompensimit, transferimit të të drejtave ose borxheve, heqjes dorë nga borxhet e raste të ngjashme.

3. Tatimpaguesi që kryen pagesën, kur dorëzon në bankë ose në institucionin tjetër financiar jobankar urdhrin e pagesës së faturave elektronike të marra, duhet të paraqesë së paku informacionin e mëposhtëm:

a) NIPT-in;

b) informacionin për NIVF-në e faturës elektronike, me të cilën ka të bëjë urdhri i pagesës ose në mënyrë të veçantë NSLF-në, kur nuk ka NIVF në faturë, në përputhje me nenin 29 të ligjit;

c) shumën për t'u paguar.

Tatimpaguesi që plotëson urdhrin e pagesës është përgjegjës për korrektësinë dhe saktësinë e këtyre të dhënave.

Neni 5

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet sipas afateve të parashikuara në ligj.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 196 lekë